



VENDIM

Nr.15 Datë 11.02.2015

PËR

FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË LICENSIMIT TË SHOQËRISË “GAEA-ENERGJIA ALTERNATIVE E GJELBËR” SH.P.K. NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të neneve 3 pika 35 ,8 gërma “a”; 9 dhe 13 pika 1, gërma “d” të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neni 4, pika 1, gërma “g” ; 8, neni 10 pika 1 dhe 3 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.02.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria GAEA- ENERGJIA ALTERNATIVE E GJELBËR sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “GAEA-ENERGJIA ALTERNATIVE E GJELBER” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë/të pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave” si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

- Neni 9, pika 1
Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 9, pika 2
Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është i plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 9, pika 3
Dokumentacioni finciar dhe fiskal është i plotësuar në gjuhën Greke.Sipas nenit 8 pika 3 dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi duhet të jetë në gjuhën Shqipe.

- Neni 9, pika 4/10, gërma a e plotësuar.
- Neni 9, pika 4/10, gërma b i pa plotësuar.
- Neni 9, pika 4/10, gërma c e plotësuar.
- Per dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit te Plote/te Pjesshem dhe Rinovimit te Licensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, ti paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë **GAEA-ENERGJIA ALTERNATIVE E GJELBER sh.p.k.**, për licencimin në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI